

Vendim nr. 58, datë 23.02.2026

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Sandër Beci, anëtarë, në datën 23.02.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 27 (K) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KLAJDI MERKAJ**, përfaqësuar nga avokat Ermir Beta, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 86, datë 29.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 144, datë 23.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 64 (87-2024-364), datë 12.12.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-358, datë 27.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

BAZA LIGJORE: **Nenet 27, 28, 41, pika 1, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27 e vijues, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 75, datë 14.04.2022 (*procedimi penal nr. 75/2022*) për veprat penale “Vrasja me paramendim”, të mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunimin e posaçëm të grupit të strukturuar kriminal, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, shpërthyes dhe municionit”, të kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuara nga neni 78, paragrafi 2, i Kodit Penal (*KP*) në lidhje me nenet 22, 278, 28, pika 4, 333/a dhe 334, 287, 302 etj., të këtij kodi, ndaj disa personave nën hetim si pjesëtarë të një organizate kriminale dhe ndër të tjerë edhe ndaj kërkuesit Klajdi Merkaj.

2. Në kuadër të këtij procedimi penal Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) me kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit, si i dyshuar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 287, paragrafi 2 dhe 25, pasi dyshohet që nga viti 2020 e në vijim e ka kryer këtë veprimtari në bashkëpunim me shtetasin F.G. (alias Ç.), si dhe persona të tjerë të paidentifikuar.

3. Mbi këtë kërkesë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 86, datë 29.07.2024, ndër të tjerë, ka vendosur caktimin edhe ndaj kërkuesit të masës “Arresti në burg”. Kjo masë sigurimi është ekzekutuar në datën 20.11.2024, pas ekstradimit nga Italia në Shqipëri dhe, në vijim, në përputhje me nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka marrë në pyetje kërkuesin e arrestuar, me qëllim verifikimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës, si dhe të nevojave të sigurimit. Në përfundim, me vendimin nr. 144, datë 23.11.2024, ajo gjykatë, ndër të tjera, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës “Arresti në burg” ndaj kërkuesit. Kundër këtij vendimi, sikundër edhe atij për caktimin e masës së sigurimit, kërkuesi ka paraqitur ankim.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 64 (87-2024-364), datë 12.12.2024, ka vendosur miratimin e vendimeve të GJKKO-së të Shkallës së Parë për caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të masës

së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuesit, me vendimin nr. 00-2025-358, datë 27.02.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

5. Në datën 12.11.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 13.02.2026 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

6.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi atij nuk i janë garantuar të drejtat për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes hetimore dhe provat në ngarkim të tij. Në kushtet kur caktimi i masës është zhvilluar në dhomën e këshillimit, i takonte apelit dhe Gjykatës së Lartë të zhvillonin një gjykim, ku atij t’i garantohej mbrojtja. Po ashtu, Gjykata e Lartë duhej ta zhvillonte gjykimin me praninë e palëve dhe jo në dhomën e këshillimit.

6.1.2. *Parimit të prezumimit të pafajësisë dhe parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi gjykatat kanë përdorur në arsyetimet e vendimeve të tyre kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të lartë, të cilat u atribuohen personave të tjerë, ndërkohë që kërkuesi dyshohet për kryerjen e vetëm një veprë penale. Përdorimi i këtyre rrethanave përbën shkelje të rëndë të nenit 30 të Kushtetutës. Konkretisht, rëndimi i pozitës së kërkuesit dhe tejkalimi i kufijve të shqyrtimit në apel, duke shtuar fakte e akuza që nuk janë pretenduar as nga prokurori, as nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë përbëjnë shkelje edhe të parimit të paanshmërisë.

6.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi në vendimet gjyqësore nuk pasqyrohen të gjitha komunikimet dhe faktet që i atribuohen atij dhe as mënyra sesi ai është identifikuar si përdorues i SKY ECC. Gjithashtu, rezulton se gjykatat nuk kanë arsyetuar në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së “Hysa kundër Shqipërisë” dhe “Gëllçi kundër Shqipërisë”.

6.2. *Liria personale*, pasi nga vendimet e gjykatave rezulton se e vetmja provë mbi të cilën pretendohet fajësia janë komunikimet në aplikacionin SKY ECC të përfituara nëpërmjet letërporosisë. Mbi bazën e këtyre komunikimeve rezulton se

kërkuesi ka komunikuar me shtetasin F.G. (alias Ç.), duke i kërkuar disa hua në vlera të mëdha dhe duke u përfshirë në shitblerje pronash të paluajtshme dhe automjesh, ndërkohë që nga ana e Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatave nuk është arritur të provohet nëse këto shuma janë përfituar realisht nga ana e tij. Gjithashtu, edhe në rast se do të merrej i mirëqenë fakti se komunikimi është kryer, nuk është arritur të vërtetohet fakti se ai e dinte burimin e parave të kërkuara. Po ashtu, nuk ka asnjë provë që vërteton se pasuria që zotëron kërkuesi nuk ka një burim të ligjshëm.

Për sa u takon provave që konfirmojnë rrezikun e largimit, gjykatat kanë përdorur arsyetime stereotipe dhe alogjike njësoj si për rrezikun e prishjes së provave për shkak të lidhjeve të supozuara të tij. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh faktin se edhe pas nisjes së procedimit ai ka udhëtuar shpesh jashtë shtetit, duke pasur mundësi reale t'i shmangej drejtësisë, si dhe faktin se duke qenë pronar biznesi ka lidhje të forta me Shqipërinë. Gjithashtu, rrethanë lehtësuese përbën edhe fakti se ai është vetëdorëzuar në Romë dhe nuk ka kundërshtuar procedurat e ekstradimit.

- 6.3. *Parimi i proporcionalitetit*, pasi nga tërësia e fakteve të çështjes rezulton se nevojat e sigurimit mund të arriheshin me një masë më të lehtë, ndërkohë që gjykatat nuk kanë arritur të arsyetojnë lidhur me ekzistencën e kushteve që lejojnë caktimin e masës, duke u bazuar në arsyetime shabllon. Masa ekstreme e sigurimit është caktuar megjithëse nuk ekziston rreziku i ikjes, i prishjes së provave dhe i kryerjes së veprave të tjera penale, por vetëm duke u bazuar tek rrezikshmëria e veprës penale për të cilën dyshohet.

Gjykatat nuk kanë dhënë asnjë argument se pse masa e sigurimit nuk mund të ndryshohej në një më të lehtë, siç është ajo “Garancia pasurore”, e cila mund të jepet në rastet kur nuk ekziston rreziku i ikjes, siç edhe ka rezultuar në rastin e kërkuesit.

- 6.4. *E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, e garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës*, pasi gjykatat nuk referojnë asnjë vendim të prokurorit ose gjykatës që ka autorizuar ndërhyrjet në komunikimet e kërkuesit, si dhe nuk referojnë asnjë vendim për kryerje ekspertimi të aparateve telefonike. Po ashtu, nuk ka prova që vërtetojnë lidhjen e kërkuesit me kodet e përdoruesve që i atribuohen atij. Gjithashtu, në vendimet e gjykatave nuk gjendet e arsyetuar mënyra sesi këto përgjime janë siguruar dhe aktet përkatëse procedurale.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimimin e kërkuësit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në këtë këndvështrim, kërkuësi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor. Megjithatë, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 17, datë 13.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuësi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta për kërkesën e tij për ndryshimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, ndaj ai i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohej Gjykatës.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa

është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në çështjen objekt shqyrtimi, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 27.02.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 12.11.2025. Nga ana e kërkuesit, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, është paraqitur *e-mail*-i i dërguar nga Gjykata e Lartë që i ka komunikuar vendimin e saj në datën 15.07.2025. Në këto kushte, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor e për pasojë kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

13. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, parimit të prezumimit të pafajësisë lidhur me parimin e paanshmërisë, si dhe cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Po ashtu, ai ka pretenduar edhe cenimin e lirisë personale, parimit të proporcionalitetit dhe së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

14. Kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *së drejtës së aksesit*, pasi atij nuk i janë garantuar të drejtat për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes hetimore dhe provat në ngarkim të tij. Në kushtet kur caktimi i masës është zhvilluar në dhomën e këshillimit, i takonte apelit dhe Gjykatës së Lartë të zhvillonin një gjykim ku atij t'i garantohej mbrojtja. Po ashtu, Gjykata e Lartë duhej ta zhvillonte gjykimin me praninë e palëve dhe jo në dhomën e këshillimit.

15. Për sa i takon njohjes me të gjitha provat që ka dosja hetimore, Kolegji Penal ka arsyetuar se neni 105 i KPP-së i jep të drejtën personit nën hetim që të paraqesë kërkesa në lidhje me aktet e hetimit paraprak përpara prokurorit, i cili ka kompetencën dhe autoritetin për të vendosur lidhur me to. Ajo gjykatë argumenton se sipas aktit "Procesverbal" të datës 20.11.2024 të Prokurorisë së Posaçme "Për ekzekutimin e masës së sigurisë për shtetasin Klajdi Merkaj", personi nën hetim është vënë në dijeni të së drejtës për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes hetimore që në momentin e njoftimit të vendimit për caktimin e kësaj mase, moment nga i cili i kanë lindur të gjitha të drejtat dhe garancitë procedurale të parashikuara nga neni 34/b i KPP-së, gjë që provohet nga marrja dijeni sipas letrës të të drejtave të të

arrestuarit/ndaluarit, të nënshkruar prej tij. Bazuar në nenin 105 të KPP-së, mbrojtësit e kërkuesit kanë pasur të gjithë kohën e nevojshme për të paraqitur kërkesë duke shfrytëzuar kohën në dispozicion. Në këtë linjë, edhe GJKKO-ja e Apelit, arsyeton ajo gjykatë, me të drejtë ka çmuar se kërkesa ishte e pabazuar, për sa kohë që sipas KPP-së ky lloj kërkimi ishte në kompetencë të prokurorit.

16. Lidhur me këtë pretendim Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se e drejta për t'u njohur me aktet, në përputhje me garancinë e nenit 28 të Kushtetutës, rregullohet nga KPP-ja në nenin 34/a, ku parashikohet e drejta e personit të arrestuar/ndaluar të njihet me materialet e çështjes, sipas parashikimeve të Kodit. Ndërkohë, neni 279 i KPP-së, në pikën 1 të tij, përcakton se në rast nevojë për vazhdimin e hetimeve prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve. Nga pikëpamja e organit kompetent që vendos aksesin në këto akte, neni 105 i KPP-së sanksionon se kërkesa për kopje ose ekstrakte të provave, për aktet e hetimit paraprak, shqyrtohet nga prokurori.

17. Gjithashtu, lidhur me këtë pretendim rezulton se sipas GJEDNJ-së e drejta për të disponuar provat përkatëse nuk është një e drejtë absolute, pasi në një procedim penal mund të ketë interesa konkurrues, siç janë: siguria kombëtare ose nevoja për të mbajtur sekret metoda të policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të priorizohen kundrejt të drejtave të të akuzuarit (*shih Jaspar kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM]nr. 27052/95, datë 16 shkurt 2000, § 52*). Në disa raste mund të jetë e nevojshme që mbrojtjes të mos i vihen në dispozicion disa prova për të ruajtur të drejtat themelore të një individi tjetër ose për të mbrojtur një interes të rëndësishëm publik. Në vlerësimin e garancive përkatëse procedurale, Gjykata duhet të ketë parasysh rëndësinë e materialit të pazbuluar dhe përdorimin e tij në gjykim (*shih Yuksel Yalcinkaya kundër Turqisë nr. 15699/20, datë 23 shtator 2023, § 71*).

18. Në këtë kuadër, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se përgjigja e marrë nga arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është e mbështetur në dispozitat e KPP-së. Për më tepër, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se kufizimi i së drejtës për t'u njohur me aktet lidhet pikërisht me sekretin hetimor, për sa kohë që provat e sjella me letërporosi nga autoritetet franceze përmbanin informacion edhe për shtetas të tjerë të cilët dyshohen si të përfshirë në aktivitet kriminal. Mbi këto argumente, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

19. Për sa i takon ushtrimin të *së drejtës së mbrojtjes*, pavarësisht se legjislacioni procedural parashikon zhvillimin e seancës së caktimit të masës në dhomën e këshillimit, mbrojtësit e kërkuesit kanë qenë të pranishëm dhe kanë realizuar të drejtën e mbrojtjes si në vendimin për marrjen në pyetje të personit të dyshuar, ashtu dhe në seancën e zhvilluar në apel për miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke përfaqësuar interesat dhe mbrojtjen e kërkuesit.

20. Mbledhja e Gjyqtarëve, gjithashtu, vëren se për sa i takon mënyrës së zhvillimit të seancës në Gjykatë të Lartë, sipas ligjit procedural, shqyrtimi i pranueshmërisë së rekursit bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Në këto kushte, shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuarit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga ligji. Për më tepër, një formë e tillë gjykimi edhe në rastet kur rekursi ka kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, nuk është vlerësuar nga Gjykata se cenon të drejtën e palëve për t'u mbrojtur dhe dëgjuar, duke u shprehur se shqyrtimi i rekursit në seancë në dhomën e këshillimit, pra mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt kjo e drejtë realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve (*shih vendimin nr. 43, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkuarit i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur (*shih vendimet nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në këtë kontekst, bazuar në dispozitat procedurale të KPP-së, sipas të cilave shqyrtimi i pranueshmërisë së rekursit bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, ajo gjykatë ka kryer shqyrtimin paraprak të rekursit të kërkuarit, duke arritur në përfundimin se ai nuk plotësonte kriteret për shqyrtimin e tij në seancë gjyqësore, referuar nenit 432 të KPP-së. Në këto kushte, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se ndryshe nga sa pretendon kërkuari, shqyrtimi paraprak i rekursit të tij nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga ligji procedural. Për rrjedhojë, lidhur me këtë argument, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se vetëm fakti se çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit është i pamjaftueshëm për të mbështetur pretendimin e kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit. Prandaj, ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

22. Kërkuari, gjithashtu, ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* dhe parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi gjykatat kanë përdorur në arsyetimet e vendimeve të tyre kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të lartë, të cilat u atribuohen personave të tjerë, ndërkohë që kërkuari dyshohet për kryerjen vetëm të një veprave penale. Përdorimi i këtyre rrethanave përbën shkelje të rëndë të nenit 30 të Kushtetutës. Konkretisht, rëndimi i pozitës së kërkuarit dhe tejkalimi i kufijve të shqyrtimit në apel, duke shtuar fakte e akuza që nuk janë pretenduar as nga prokurori, as nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë përbëjnë shkelje edhe të parimit të paanshmërisë.

23. Gjykata ka theksuar se Kushtetuta lejon shprehimisht kufizimin e lirisë personale për shkak të interesit publik që lidhet me mbarëvajtjen e procedimit penal dhe dhënien e drejtësisë (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Lidhur me këtë pretendim të kërkuesit, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se nga aktet bashkëlidhur ankimit rezulton se GJKKO-ja e Apelit nuk i ka atribuar atij kryerjen e veprave të tjera penale, por ka referuar veprat e kryera në tërësi nga organizata kriminale e hetuar në procedimin penal nr. 75/2022 dhe drejtuesi i saj, në kushtet kur kërkuesi dyshohet se veprën penale e ka kryer në formën e bashkëpunimit me drejtuesin e grupit të strukturuar kriminal, për të vlerësuar rrezikshmërinë e tyre. Ndërkohë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se për sa i takon cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, në kushtet kur ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm justifikon në nivel kushtetues kufizimin e lirisë personale, pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë nuk mund të merret në shqyrtim, pasi haptazi nuk rezulton të jetë cenuar nga masa e sigurimit e zbatuar nga gjykatat.

25. Një pretendim tjetër i kërkuesit është edhe cenimi i *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, të garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk referojnë asnjë vendim të prokurorit ose gjykatës që ka autorizuar ndërhyrjet në komunikimet e kërkuesit, si dhe nuk referojnë asnjë vendim për kryerje ekspertimi të aparateve telefonike. Po ashtu, nuk ka prova që vërtetojnë lidhjen e kërkuesit me kodet e përdoruesve që i atribuohen atij. Gjithashtu, në vendimet e gjykatave nuk gjendet e arsyetuar mënyra sesi këto përgjime janë siguruar dhe aktet përkatëse procedurale.

26. Gjykata ka pohuar se komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC u janë përcjellë autoriteteve shqiptare nga autoritetet gjyqësore franceze përmes letërporosisë në bazë të parashikimeve të KPP-së dhe të Konventës së Këshillit të Evropës “Për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale”. Autoritetet gjyqësore franceze kanë vepruar në ekzekutim të letërporosisë së dërguar nga autoritetet e drejtësisë shqiptare, për transmetimin e të dhënave nga përgjime të marra prej Gjykatës së Parisit, në përputhje me nenin 3 të Konventës së Këshillit të Evropës, në bazë të të cilit parashikohet parimi i përgjithshëm i prezumimit të ligjshmërisë së marrjes se tyre nga autoritetet gjyqësore të një shteti anëtar të Konventës për ndihmë juridike në fushën penale. Gjykata vëren se, në bazë të nenit 26, pika 1, të Konventës “Për krimin në fushën e kibernetikës”, të ratifikuar me ligjin nr. 8888, datë 25.04.2002, parashikohet edhe dhënia e informacionit spontan dhe, sipas saj, brenda kufijve të ligjit të brendshëm dhe pa kërkesë paraprake, një palë mund t’i ofrojë një palë tjetër informacionin e marrë në kuadrin e hetimeve të veta kur konsideron se dhënia e një informacioni të tillë mund të ndihmojë palën marrëse në fillimin ose kryerjen e hetimeve ose gjykimeve në lidhje me veprat penale të përcaktuara në këtë konventë ose mund të çojë në bërjen e një kërkesë për

bashkëpunim nga kjo palë. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC janë përcjellë nga autoritetet franceze në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë mes autoriteteve të të dyja vendeve, pra në përputhje me parimin e besimit reciprok në marrëdhëniet mes autoriteteve gjyqësore të huaja (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se mënyra e marrjes së provave nëpërmjet letërporosisë nga aplikacioni Sky ECC konsiderohet e ligjshme si referuar KPP-së, ashtu edhe në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë në përputhje me parimin e besimit reciprok në marrëdhëniet mes autoriteteve gjyqësore të huaja, për rrjedhojë edhe ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

28. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *lirisë personale*, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuari e ka argumentuar në drejtim të standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova dhe parimit të proporcionalitetit. Nga ana tjetër, kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor edhe në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pikërisht në lidhje me dy aspektet e lirisë personale të pretenduar si të shkelur. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka pohuar se liria personale ka dy anë: atë substanciale, që garantohet nga neni 27 i Kushtetutës dhe atë procedurale, që garantohet nga neni 28 i lidhur me nenin 42 të Kushtetutës. Në rastet e kontrollit të vendimeve që caktojnë masat e sigurimit personal, ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 86, datë 20.12.2024; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Për sa më lart, duke vlerësuar se pretendimi i kërkuarit për cenimin e lirisë personale bën pjesë në juridiksionin kushtetues, Gjykata në vijim do ta analizojë atë në aspektin substancial në drejtim të: i) standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova dhe ii) parimit të proporcionalitetit.

B. Për pretendimin për cenimin e lirisë personale.

B.1. Në lidhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova

30. Kërkuari ka pretenduar se nga vendimet e gjykatave rezulton se e vetmja provë mbi të cilën pretendohet fajësia janë komunikimet në aplikacionin SKY ECC të përfituara nëpërmjet letërporosisë. Mbi bazën e këtyre komunikimeve rezulton se kërkuari ka

komunikuar me shtetasin F.G. (alias Ç.), duke i kërkuar disa hua në vlera të mëdha dhe duke u përfshirë në shitblerje pronash të paluajtshme dhe automjete, ndërkohë që nga ana e Prokurorisë së Posaçme dhe gjykatave nuk është arritur të provohet nëse këto shuma janë përfituar realisht nga ana e tij. Gjithashtu, edhe në rast se do të merrej i mirëqenë fakti se komunikimi është kryer, nuk është arritur të vërtetohet fakti se ai e dinte burimin e parave të kërkuara. Po ashtu, nuk ka asnjë provë që vërteton se pasuria që zotëron kërkuesi nuk ka një burim të ligjshëm. Kërkuesi, gjithashtu, ka pretenduar se në vendimet gjyqësore nuk pasqyrohen të gjitha komunikimet dhe faktet që i atribuohen atij dhe as mënyra sesi ai është identifikuar si përdorues i SKY ECC.

31. Neni 27 i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (paragrafi 1), ndërsa liria e personit mund të kufizohet kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale (paragrafi 2, shkronja "c"). Kurse neni 28 i Kushtetutës parashikon se personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi "c", duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirim e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim (paragrafi 2) dhe se i paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit (paragrafi 3).

32. Gjykata ka pohuar se qëllimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një "shoqëri demokratike". Kërkesa "dyshime të arsyeshme" për kryerjen e veprës penale që justifikon kufizimin e lirisë personale të individit, nënkupton ekzistencën e fakteve ose të informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal (*shih vendimet nr. 86, datë 20.12.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 19, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Po sipas Gjykatës, në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar nga KPP-ja, ku në rastin e caktimit të masës së sigurimit, neni 228, pika 1, i saj, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja "c", të Kushtetutës, përcakton si kusht i domosdoshëm (*sine qua non*) ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individi ka kryer një veprë penale (*shih vendimet nr. 86, datë 20.12.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 19, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Mosbërja e një hetimi të vërtetë nga ana e autoriteteve mbi faktet e çështjes, për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm, do të përbënte

cenim të nenit 27 të Kushtetutës. Për të vlerësuar nëse është respektuar standardi i dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për arrestimin e një individi, mbahet në konsideratë konteksti i përgjithshëm i fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi dhe sjelljen e autoriteteve. *(shih vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

35. Për sa më lart dhe referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues, Mbledhja e Gjyqtarëve do të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme e kanë mbështetur mbi prova të mjaftueshme dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi e ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet.

36. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në kuadër të procedimit penal, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, është caktuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë masa e sigurimit personal “Arresti në burg” për kërkuesin e më tej është konfirmuar kjo masë gjatë marrjes në pyetje nga po ajo gjykatë. Në vijim, masa e sigurimit është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

37. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, lidhur me caktimin e masës së sigurimit të kërkuesit e më tej me verifikimin e kushteve për vijimin e masës, ka arsyetuar se provat e administruara, të cilat janë pjesë e dosjes penale të gjykimit, tregonin të dhëna të qarta se kërkuesi mund të ketë kryer veprën penale për të cilën është regjistruar emri i tij si person nën hetim në kuadër të procedimit penal objekt shqyrtimi. Ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuesi dyshohet se ka kryer veprën penale në bashkëpunim me shtetasin F.G. (alias Ç.), i cili, nga ana tjetër, dyshohet për kryerjen e veprës së rëndë penale të krijimit dhe drejtimit të organizatës kriminale dhe në kuadër të kësaj organizate kriminale ka kryer një sërë veprash penale të rënda. Ajo gjykatë ka arsyetuar se nga Prokuroria e Posaçme është bërë analizë për individualizimin e numrave pin të aplikacionit SKY ECC, si dhe lidhjen e tyre me personin konkret, ndërkohë që pohon se jo të gjitha burimet e provat që disponoheshin ishin paraqitur në vendim me qëllim mosdëmtimin e hetimeve.

38. Gjithashtu, nga ana e GJKKO-së së Shkallës së Parë, në vendimin e caktimit të masës së sigurimit ndaj tij janë listuar edhe episodet kriminale në kuadër të faktit penal, për të cilat kërkuesi dyshohet si një nga personat e besuar të grupit që mbante e menaxhonte vlera të konsiderueshme monetare, duke ditur se ato ishin produkt i veprimtarisë kriminale. Ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuesi dyshohet se ka marrë disa hua në vlera të mëdha nga organizata kriminale, duke u përfshirë në shitblerje pronash të paluajtshme dhe automjeteve, si dhe në transporte vlerash monetare, të cilat janë investuar më pas në ndërtim. Gjithashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë krahas episodeve kriminale ka renditur edhe marrjen e deklarimeve nga bashkëpunëtori i drejtësisë, shtetasit E.A. dhe këqyrjen e sistemit TIMS. E njëjta gjykatë gjatë

verifikimit të kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës së sigurimit ka urdhëruar vazhdimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” për kërkuesin.

39. GJKKO-ja e Apelit, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e kërkuesit, ka vlerësuar të drejtë vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke e miratuar atë. Ajo gjykatë i ka konsideruar të bazuara vlerësimet e shkallës së parë dhe për sa i takon identifikimit të kërkuesit, ajo gjykatë argumenton se është faktuar nga provat e marra nga autoritetet franceze. Lidhur me dyshimin e arsyeshëm të mbështetur në prova, apeli arsyeton se provat dhe të dhënat e grumbulluara deri në këtë fazë të hetimit paraprak janë të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin se fakti penal që i atribuohet kërkuesit të dyshuar ka ndodhur dhe ai rezulton si bashkëpjesëmarrës në aktivitetin e paligjshëm për të cilin dyshohet. Gjithashtu, GJKKO-ja e Apelit ka renditur edhe provat e grumbulluara, si letërporositë lidhur me aplikacionin SKY ECC, si dhe kryqëzimin e tyre me prova të tjera të përfituara gjatë hetimit, siç janë deklaratimet e bashkëpunëtorit të drejtësisë, shtetasit E.A. dhe këqyrja e sistemit TIMS.

40. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nga ana e tij, mbi rekursin e kërkuesit, ka arsyetuar se nuk ekzistojnë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Ai kolegji arsyeton se gjykatat e faktit kanë zbatuar drejt ligjin procedural penal, duke analizuar dhe dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të ngritura nga kërkuesi. Kolegji Penal ka arsyetuar se dyshimi i arsyeshëm nuk është bazuar vetëm në komunikimet SKY ECC, por edhe në prova të tjera të përfituara gjatë hetimit të vlerësuara edhe nga gjykatat e faktit.

41. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se GJKKO-të e faktit dhe Gjykata e Lartë, në caktimin e masës së sigurimit personal të arrestit në burg ndaj kërkuesit, me të drejtë kanë vlerësuar se ekzistonin kushtet për vendosjen e saj në fazat fillestare të hetimit. Gjithashtu, të tria gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm për faktet që kanë shërbyer si bazë për caktimin e masës së sigurimit personal, ndërkohë që pretendimet e kërkuesit të rrëzuara nga ato lidhen me themelin e çështjes dhe jo me këtë fazë të procedimit.

42. Në këndvështrim të sa më lart dhe duke mbajtur parasysh standardet e sipërpërmendura, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen prej tij të veprës penale për të cilën dyshohet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Në këtë drejtim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit kanë evidentuar në vendimet e tyre ekzistencën e fakteve që mbështesin dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi mund të ketë kryer veprën penale për të cilën dyshohej. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet mospranimit të rekursit, i ka konsideruar të drejta argumentet e dhëna nga ato gjykata, si dhe ka arsyetuar gjetjet në drejtim të të drejtave procedurale dhe kushtetuese të kërkuesit duke u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve dhe duke argumentuar se dyshimi i arsyeshëm nuk është bazuar

vetëm në letërporositë mbi komunikimet në platformën SKY ECC, por edhe në prova të tjera të përfituara gjatë hetimit, ku mund të veçohen deklaratimet e bashkëpunëtorit të drejtësisë E.A. Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme, të cilat vlerësojnë faktet e çështjes, janë në pozitë më të favorshme për drejtpeshimin e nevojave të sigurimit dhe vendimmarrja e tyre analizohet nga Gjykata vetëm në drejtim të respektimit të garancive kushtetuese të lidhura me caktimin e masave të sigurimit. Nëpërmjet shqyrtimit kushtetues, Gjykata nuk merr rolin e gjykatave të zakonshme dhe nuk zëvendëson vlerësimet e tyre me të sajat, por mbikëqyr zbatimin e standardeve kushtetuese sipas mishërimit të tyre në arsyetimin e vendimeve gjyqësore objekt të ankimit kushtetues.

43. Në dritën e këtyre konsideratave, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në çështjen penale ndaj kërkuesit duket se ka të dhëna që do të bindnin një vëzhgues të paanshëm se ai mund të ketë kryer veprën penale për të cilën është dyshuar dhe gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm në këtë drejtim. Ndaj nuk mund të konkludohet se kërkuesi është arrestuar në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 27, paragrafi 2, shkronja “c”, të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë personale me argumentin e mungesës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova janë haptazi të pabazuara.

B.2. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit

44. Kërkuesi ka parashtruar që për sa u takon provave që konfirmojnë rrezikun e largimit, gjykatat kanë përdorur arsyetime stereotipe dhe alogjike njësoj si për rrezikun e prishjes së provave për shkak të lidhjeve të supozuara të tij. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh faktin se edhe pas nisjes së procedimit ai ka udhëtuar shpesh jashtë shtetit, duke pasur mundësi reale t'i shmangej drejtësisë, si dhe faktin se duke qenë pronar biznesi ka lidhje të forta me Shqipërinë. Gjithashtu, rrethanë lehtësuese përbën edhe fakti se ai është vetëdorëzuar në Romë dhe nuk ka kundërshtuar procedurat e ekstradimit.

45. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe se nga tërësia e fakteve të çështjes rezulton se nevojat e sigurimit mund të arriheshin me një masë më të lehtë, ndërkohë që gjykatat nuk kanë arritur të arsyetojnë lidhur me ekzistencën e kushteve që lejojnë caktimin e masës, duke u bazuar në arsyetime shabllon. Masa ekstreme e sigurimit është caktuar megjithëse nuk ekziston rreziku i ikjes, i prishjes së provave dhe i kryerjes së veprave të tjera penale, por vetëm duke u bazuar tek rrezikshmëria e veprës penale për të cilën dyshohet. Sipas tij, gjykatat nuk kanë dhënë asnjë argument se pse masa e sigurimit nuk mund të ndryshohej në një më të lehtë, siç është ajo “Garancia pasurore”, e cila mund të jepet në rastet kur nuk ekziston rreziku i ikjes, siç dhe ka rezultuar në rastin e kërkuesit. Gjithashtu, rezulton se gjykatat nuk kanë arsyetuar

në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së “Hysa kundër Shqipërisë” dhe “Gëllçi kundër Shqipërisë”.

46. Gjykata ka pohuar se çdo masë që kufizon liritë dhe të drejtat e individit duhet të jetë në përputhje me ligjin, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të respektojë një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave e lirive të tij. Një ndërhyrje do të konsiderohet “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për një qëllim të ligjshëm nëse i përgjigjet një “nevoje sociale urgjente” dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e gjykatave për ta justifikuar atë janë “relevante dhe të mjaftueshme”. Testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes kërkon që masa të jetë e përshtatshme për të arritur funksionin mbrojtës. Me fjalë të tjera, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për atë që ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Në vijim, në drejtim të kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata analizon arsyetimin e gjykatave të zakonshme në drejtim të aspekteve të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë në raport me parashikimet e neneve 228, 229 e vijues të KPP-së (*shih vendimet nr. 1, datë 17.01.2025; nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Sipas nenit 28, pika 3, fjalia e dytë, të Kushtetutës, i paraburgosuri ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit. Këto garanci gjenden edhe në paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së, sipas të cilit çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1, shkronja “c”, të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit, lirim që mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t’u paraqitur në procesin gjyqësor.

48. Gjykata, bazuar në jurisprudencën e saj për nenin 28, pika 3, të Kushtetutës, ka theksuar se kjo dispozitë rregullon kohëzgjatjen e paraburgimit dhe mbron situatën kur paraburgimi nuk justifikohet më me arsye të interesit publik, ndaj këto garanci u japin autoriteteve gjyqësore një zgjedhje midis dërgimit të personit të akuzuar në gjyq brenda një kohe të arsyeshme ose lirim të përkohshëm në pritje të gjykimit. Qëllimi i tyre është, në thelb, që i paraburgosuri të kërkojë lirim dhe përkohshëm, atëherë kur vijimi i paraburgimit pushon së qeni i arsyeshëm dhe nuk u përgjigjet më nevojave të sigurimit. Çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkesë të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ-së. Në thelb, Gjykata ka pohuar se vijimi i ekzistencës së

dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimit të paraburgimit. Ka një dallim të dukshëm midis situatës kur autoritetet gjyqësore shqyrtojnë për herë të parë, “menjëherë” pas arrestimit, nëse personi i dyshuar do të qëndrojë në paraburgim, me situatën kur pas një kohe të caktuar nevojitet vijimi i masës së arrestit. Në rastin e fundit dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova duhet të jetë i tillë që autoritetet të japin njëkohësisht arsye të qarta e relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar vijimin e paraburgimit, konform rrethanave individuale të secilit rast penal. U takon prokurorisë dhe gjykatave të zakonshme të përcaktojnë qëndrueshmërinë e shkaqeve që justifikojnë vazhdimin e paraburgimit dhe barra e provës nuk duhet të kthehet duke i kërkuar personit të ndaluar që të provojë ekzistencën e arsyeve që garantojnë lirimin e tij, ndonëse ky i fundit nëse ka informacione që lehtësojnë pozitën e tij, duhet t’ia bëjë me dije prokurorisë ose gjykatës. Mbi këtë bazë, në vijim, Gjykata është shprehur se në kuptim të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së, i paraburgosuri ka të drejtë që të kërkojë procedimin e tij në liri dhe gjykatat janë të detyruara të marrin në konsideratë nëse ka ende arsye që justifikojnë masën kufizuese të lirisë dhe nëse nevojat e sigurimit mund të garantohen me garanci të tjera ose masa alternative, duke vlerësuar në çdo rast proporcionalitetin e masës së caktuar në drejtim të përshtatshmërisë së saj (*shih vendimin nr. 86, datë 20.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Ndërkohë, KPP-ja, në nenin 228, pika 3, përcakton kushtet e veçanta, alternative, për vendosjen e masave të sigurimit personal dhe konkretisht: kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit (shkronja “a”); kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet (shkronja “b”); kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (shkronja “c”). Neni 229 përcakton kriteret e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, duke parashikuar se gjykata mban parasysht përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret (pika 1) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast mbahen parasysht vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga KP-ja (pika 2). Kurse neni 230 përcakton kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, duke parashikuar, ndër të tjera, se një masë e tillë mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit (pika 1).

50. Për sa më lart, si dhe referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson të analizojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në caktimin e masës së sigurimit, kanë arsyetuar mjaftueshëm për ekzistencën e

shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, rrezikun që i pandehuri të largohet, si dhe rrezikun që, për shkak të rrethanave të faktit, kërkuesi të kryejë krime të tjera. Për këtë qëllim, Mbledhja e Gjyqtarëve do të mbajë në konsideratë faktet e çështjes për të përcaktuar nëse masa e caktuar ndaj kërkuesit është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur, si dhe nëse çdo masë tjetër ishte e papërshtatshme.

51. Pa rënë në përsëritje të fakteve në lidhje me proceset gjyqësore që çuan në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit dhe vazhdimin e paraburgimit të tij, sikurse më lart ato u parashtruan, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon të evidentojë në vijim arsyet e veçanta që gjykatat e zakonshme parashtruan për justifikimin e paraburgimit të kërkuesit përtej ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si dhe për sa u përket argumenteve të tyre rreth përshtatshmërisë së kësaj mase.

52. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se ekzistonin të tria kushtet e veçanta të parashikuara nga pika 3 e nenit 228 të KPP-së. Kjo konsideratë është konfirmuar nga ajo gjykatë edhe në vendimin e vlerësimit të kushteve e kritereve të caktimit të masës, duke vlerësuar se vazhdonin të ekzistonin të tria kushtet e veçanta të vlerësuara në vendimin për caktimin e masës. Konkretisht, ajo gjykatë ka arsyetuar se ekzistonte rreziku i ikjes, për shkak të rrethanave të faktit sesi ishte kryer vepra penale, të sjelljes së kërkuesit, si dhe duke marrë në konsideratë edhe marzhin e dënimit që parashikon vepra penale në fjalë. Gjithashtu, sipas saj, faktor tjetër përbën edhe lidhja e kërkuesit me Shqipërinë, mosha e re dhe statusi beqar, faza që ndodhej hetimi në kuadër të procedimit penal, duke pasur në vëmendje llojin e veprave penale të kryera dhe numrin e madh të personave që janë duke u hetuar, episodet e shumta kriminale në hetim, fakti që Prokuroria do të duhej të shtrinte hetimin dhe analizën e saj mbi një sërë dokumentesh ose ngjarjesh të ndodhura kohë më parë, që përfshijnë një sërë subjektsh, për të konkluduar për veprën penale të dyshuar. Këto rrethana bëjnë evident edhe rrezikun e marrjes dhe vërtetësisë së provave. Gjykata e shkallës së parë, gjithashtu, ka arsyetuar edhe për pretendimet se ekzistonte rrethana lehtësuese për shkak se kërkuesi ushtronte biznes në Shqipëri, duke konkluduar se ishte pikërisht kjo veprimtari e kërkuesit që ishte objekt hetimi nga Prokuroria e Posaçme.

53. Po ashtu, ajo gjykatë arsyeton se me masën e sigurimit të dhënë ruhet dhe garantohet raporti i drejtë që ekziston ndërmjet rëndësisë së faktit që hetohet, si dhe sanksionit të veprave penale të parashikuara në nenin 287, paragrafi i dytë, të KP-së, vepër e cila parashikon sanksion penal minimumi 7 vjet burgim e maksimumi 15 vjet burgim, duke qenë kështu vepër penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Në përfundim, ajo gjykatë ka konkluduar se nga analiza e kryer rezulton se masa e caktuar ndaj kërkuesit “Arrestimi në burg” është e përshtatshme dhe se

nuk rezulton të jetë prezente asnjë nga rrethanat që nuk lejojnë caktimin e kësaj lloji mase ose nevojën e ndryshimit të saj.

54. GJKKO-ja e Apelit nga ana e saj ka çmuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar drejt kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 228, 229 dhe 230 të KPP-së. Në rastin konkret ajo gjykatë ka arsyetuar se plotësohen të dyja kushtet kumulative të pikave 1 dhe 2 të nenit 228 të KPP-së. Ndërkohë, për sa u takon kushteve të veçanta të parashikuara nga pika 3 e nenit 228 të KPP-së, rezulton se ekzistojnë të tria këto kushte, rreziku i prishjes së provave, rreziku i ikjes dhe rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale. Konkretisht, ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkuesi mund të ndërhyjë në marrjen dhe prishjen e provave, duke ndikuar dhe frikësuar dëshmitarët. Për sa i takon rrezikut të largimit, apeli ka argumentuar se në kushtet kur kërkuesi është ekstraduar nga Italia, ekziston rreziku i shmangies nga drejtësia. Lidhur me rrezikun e kryerjes së veprave të tjera penale, ai është konsideruar prezent nga ajo gjykatë për shkak të aktivitetit të tij, të mënyrës sesi ka vepruar dhe lidhjeve kriminale që ka. Në lidhje me proporcionalitetin e masës, gjykata e apelit ka konkluduar se masa e vendosur është e përshtatshme në lidhje me rrezikshmërinë dhe masën e sanksionit të veprës penale për të cilën dyshohet kërkuesi, si dhe shkallën e nevojave të sigurimit për kërkuesin, i cili ka kryer veprime të shtrira në kohë për pastrimin e produkteve të veprës penale për llogari të shtetasit F.G. (alias Ç.), drejtues i organizatës kriminale të hetuar, ndërkohë që masat e tjera të sigurimit janë vlerësuar si të papërshtatshme. GJKKO-ja e Apelit, gjithashtu, ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e Prokurorisë së Posaçme se pavarësisht pretendimeve të kërkuesit se është dorëzuar dhe ka pranuar ekstradimin, fakti që ai është ekstraduar përbën tentativë për shmangien nga drejtësia.

55. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ndërkohë e ka gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatave të faktit për plotësimin e kushteve e kriterëve për caktimin e masës, si dhe proporcionalitetin e saj lidhur me nevojat e sigurimit.

56. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se të tria gjykatat e zakonshme kanë analizuar në drejtim të kushteve të veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, i KPP-së, duke dhënë edhe arsytet pse këto kushte përmbushen që të tria në rastin e kërkuesit. Ndërkohë, për sa i takon pretendimit të kërkuesit se ato gjykata nuk kanë arsyetuar në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së “Hysa kundër Shqipërisë” dhe “Gëllçi kundër Shqipërisë”, Mbledhje e Gjyqtarëve evidenton se lidhur me rrezikun e largimit, rasti i kërkuesit është i ndryshëm nga ato vendime, duke qenë se ai është ekstraduar drejt Shqipërisë, çka paraqet një situatë të ndryshme, e cila është analizuar mjaftueshëm nga gjykatat e faktit dhe, për më tepër, rasti i kërkuesit në ndryshim nga dy rastet e referuara ka ndryshim, pasi lidhet me krimin e organizuar. Gjithashtu, të tria gjykatat e zakonshme kanë pasqyruar mjaftueshëm argumente edhe në drejtim të proporcionalitetit të masës së sigurimit personal, duke parashtruar gjerësisht arsytet se përse

nevojat e sigurimit në rastin konkret diktonin caktimin ndaj kërkuesit të masës së arrestit në burg, duke vlerësuar njëkohësisht si të papërshtatshme çdo masë tjetër sigurimi personal. Për sa më lart, në planin kushtetues Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se GJKKO-të e faktit dhe Gjykata e Lartë në caktimin e masës së sigurimit personal të arrestit në burg ndaj kërkuesit kanë vepruar konform kompetencave të tyre kushtetuese e ligjore kur kanë vlerësuar se ishin kushtet për vendosjen e saj, duke parashtruar mjaftueshëm argumente edhe në drejtim të përshtatshmërisë së masës së paraburgimit të kërkuesit. Përfundimi i tyre se çdo masë tjetër nuk është e përshtatshme nuk duket i paarsyeshëm në raport me nevojat e sigurimit që janë evidentuar në rastin konkret.

57. Ndërkohë për pretendimin për ndryshimin e masës së tij të sigurimit me një më të lehtë si “Garancia pasurore”, Gjykata ka theksuar se garancia pasurore sipas nenit 28, pika 3, të Kushtetutës lidhet kryesisht me kohëzgjatjen e masës, në rast të kontrollit vijues të vendimeve për caktimin e saj. Nga ana tjetër, siç u arsyetua më lart, duke qenë se gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar masën “Arresti në burg” si masën më të përshtatshme për rastin konkret dhe njëkohësisht i kanë gjetur të papërshtatshme masat e tjera të sigurimit, përfshi edhe atë “Garancia pasurore”, vlerësimi i tyre u përmbahet kriterëve kushtetuese dhe rrjedhimisht ato vendimmarrje janë të pacenueshme në rrafshin kushtetues. Më tej, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë objektin e ankimit kushtetues, që ka të bëjë me caktimin e masës së sigurimit, parimin e subsidiaritetit dhe mjetet juridike që kërkuesi ka në dispozicion, i referohet momentit faktik kur ajo masë është vlerësuar nga gjykatat e zakonshme dhe jo kohës së kaluar nga caktimi i masës deri në momentin e shqyrtimit kushtetues. Thënë ndryshe, në respekt të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës kërkohet që pas kalimit të një kohe nga caktimi i masës së heqjes së lirisë, ajo të ketë humbur qëllimin e saj sipas kriterëve të përcaktuara në KPP, pra të mos justifikohet më me arsye të interesit publik, çka nuk është rasti në çështjen objekt ankimi kushtetues. Në këtë mënyrë, Gjykata çmon se paraqitja e kërkesës për t’u proceduar i lirë kundrejt garancisë pasurore, ndonëse mund të bëhet edhe në seancën e vleftësimit të masës së sigurimit (dhe vlerësohet nga gjykatat në drejtim të nevojave të sigurimit), mund të kërkohet edhe pas kalimit të një periudhe kohe nën masën e sigurimit që heq lirinë, ku gjykata do të duhet të verifikojë nëse ekzistojnë më kushtet dhe nevojat e sigurimit që justifikojnë vijimin e kësaj mase (*shih vendimin nr. 7, datë 28.01.2026 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Mbledhja e Gjyqtarëve lidhur me këtë pretendim vlerëson se paraqitja e kërkesës për t’u proceduar i lirë kundrejt garancisë pasurore është vlerësuar nga gjykatat e zakonshme, të cilat kanë arsyetuar në drejtim të nevojave të sigurimit duke e gjetur atë kërkesë të papërshtatshme, vlerësim i cili gjendet i mjaftueshëm në rrafshin kushtetues. Kërkesat e ardhshme që mund të paraqesë kërkuesi dhe rrethanat që mund të dalin në të ardhmen në lidhje me zbutjen, qëndrimin njësoj

ose ashpërsimin e nevojave të sigurimit, nuk i përkasin këtij shqyrtimi kushtetues, ndaj nuk merren parasysh nga Gjykata.

58. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se urdhërimi i gjykatave të zakonshme për vazhdimin e paraburgimit të kërkuesit duket se është i justifikuar mbi tregues specifikë të një kërkese të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë së tij, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë personale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së.

59. Në këtë këndvështrim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimet e kërkuesit për kufizimin e lirisë personale, për shkak të caktimit të zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” janë haptazi të pabazuara, për sa kohë që masa nuk është në raport të zhdrejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe në përshtatje me nevojat e sigurimit e rëndësishme të faktit penal për të cilin ai dyshohet, si dhe sanksionin që parashikohet nga ligji për atë veprë penale. Ky përfundim bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, të cilat i kanë dhënë përgjigje të mjaftueshme kërkuesit lidhur me nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete dhe sipas rregullave specifike të KPP-së.

60. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se vendimi objekt kundërshtimi nuk cenon kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me kufizimin ndaj kërkuesit të lirisë personale në kundërshtim me normat kushtetuese e ato procedurale penale dhe në mënyrë joproporcionale. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është haptazi i pabazuar. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të çështjes që i përket ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesi Klajdi Merkaj, me objekt “*Shfuqizimi i vendimeve gjyqësore nr. 86, datë 29.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 144, datë 23.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 64 (87-2024-364), datë 12.12.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-358, datë 27.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*”, jemi kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin se pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara, pasi vlerësojmë se çështja duhej të kalonte për shqyrtim në seancë plenare për sa u takon pretendimeve që lidhen me proporcionalitetin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, sipas analizës së kriterëve të nenit 17 të Kushtetutës, në këndvështrim të lirisë personale, sipas nenit 27 të Kushtetutës, me argumentin e mëposhtëm.
2. Në vlerësimin e kriterëve paraprake të legjitimitetit shumica ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimi kryesor i tij për cenimin e lirisë personale është haptazi të pabazuara. Sipas shumicës, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat e zakonshme u kanë dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të tij lidhur me proporcionalitetin e caktimit të masës së sigurimit personale “Arresti në burg”.
3. Ne, gjyqtarët në pakicë, ndërsa pajtohemi me shumicën për pabazueshmërinë e pretendimeve të tjera që lidhen me themelin e çështjes, nuk pajtohemi me qëndrimin e shumicës lidhur me pretendimin për cenimin e *parimit të proporcionalitetit* në caktimin e masës së sigurimit. Këtë qasje tonën e bazojmë në qëndrimet tashmë të konsoliduara të kësaj Gjykate, e cila ka vendosur në plot raste trajtimin e këtij parimi në seancë plenare (*shih vendimet nr. 01, datë 17.01.2025; nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 83, datë 05.12.2024; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 7, datë 28.01.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).
4. Për sa më lart, çmujmë se edhe në këtë rast, Mbledhja e Gjyqtarëve do të duhej të kishte shqyrtuar pretendimin për cenimin e parimit të proporcionalitetit në drejtim të

kufizimit të lirisë personale në seancë plenare, për të shqyrtuar elementet e ashpërsisë, domosdoshmërisë dhe nevojës së masës së sigurimit në rastin konkret.

Anëtarë: Sonila Bejtja, Sandër Beci